


Eksportet e fasonit sipas shteteve '11-'12 (mln lek)



BURIMI: INSTAT

Ky efekt negativ pritet të jetë i përkohshëm dhe porositë pritet të marrin ritmet normale të rritjes të vitit të kaluar

FASONI, BIEN EKSPORTET DREJT GJERMANISË E GREQISË

Nga Laura ÇELA

Ritja e vazhdueshme e ekonomisë së Gjermanisë, edhe në këtë periudhë krize, duket se nuk i ka ndihmuar eksportet shqiptare drejt këtij shteti. Eksportet e tekstileve dhe këpucëve (fason) drejt Gjermanisë kanë pësuar rënie të ndjeshme në tremujorin e parë të këtij. Ato janë reduktuar me afro 35%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shkaku kryesor duket se është rënia e shitjeve në tregjet gjermane. “Është e vërtetë që kemi shënuar eksporte më të ulëta. Fakt është që efekti vjen nga rënia e shitjeve, kryesisht të veshjet e punës”, thotë Bardhi Sejdarasi nga Dhoma e Prodhuesve të Veshjeve. Në fillim të këtij viti, një fabrikë e prodhimit të veshjeve gjermane ka ndaluar



aktivitetin e saj në Shqipëri, duke ulur automatikisht edhe eksportet drejt këtij shteti. Por fasonistët thonë se ky efekt negativ do të jetë i përkohshëm dhe porositë pritet të marrin ritmet normale të rritjes të vitit të kaluar. “Nga kontaktet që kemi me partnerët tanë gjermanë, na është komunikuar se

porositë janë ulur, për shkak të mungesës së lëndëve të para, dhe jo se ka rënie të peshës në treg. Pritet që këtë muaj të kemi rritje të mëtejshme të porositë”, thotë Shpresa Prodani, administratore e ndërmarrjes së veshjeve “Dyrrah” në qytetin e Durrësit.

Fakti që eksportet e fasonit drejt Gjermanisë zënë ende një peshë të vogël, vetëm 3.5% të tyre, bën që efekti negativ i saj në balancën totale të eksporteve tekstile dhe këpucë të jetë shumë i vogël. Në total, eksportet e tekstileve dhe këpucëve kanë rënë 3.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Performanca e mirë e eksporteve erdhi nga ruajtja e nivelit të eksporteve (rieksportove) të tekstile-këpucëve, të cilat zunë 52% të totalit të vlerës së eksportuar në Itali, për periudhën janar-mars 2012. Me gjithë krizën ekonomike që ka mbërthyer Italinë, shitjet e veshjeve duket se po ecin me ritme të kënaqshme, duke shënuar një rritje të lehtë.

Rënie kanë vijuar të kenë eksportet drejt Greqisë, rreth 11.3% më të ulëta se një vit më parë. Kriza e rëndë ekonomike në këtë vend ka ulur ndjeshëm konsumin atje dhe si rrjedhojë, edhe tregun e veshjeve.

Gjermania, ende një potencial

Por tregu gjerman mbetet ende një sfidë për fasonin shqiptar, sepse ai është sot një nga tregjet më të fuqishëm në botë. Gjergji Gjika, kryetar i Shoqatës së Fasonistëve, thotë se muajin e ardhshëm, në televizionin kombëtar gjerman do të transmetohet një dokumentar për promovimin e industrisë shqiptare së fasonit. Kjo do të pasohet me takime me përfaqësues të rëndësishëm të industrisë gjermane të veshjeve, me qëllim ofrimin e ndërmarrjeve shqiptare për një treg të fuqishëm si Gjermania. “Gjermania vijon të mbetet tregu më potencial në Europë dhe ne tashmë kemi ndërmarrë iniciativat për të promovuar industrinë tonë atje. Kemi si synim tërheqjen e investitorëve nga ky shtet”, thotë Gjika. ■

EKSPORTI SIPAS GRUP MALLRAVE DHE PARTNERËVE KRYESORË, JANAR-MARS 2012, MLN LEKË

	Itali	Greçi	Gjermani	Turqi	Të tjera
Gjithsej	25,948	2,661	1,064	1,651	14,033
Ushqim, pije duhan	1,012	432	221	48	928
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	5,833	13	0	756	7,940
Produkte kimike dhe plastike	131	36	4	31	243
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	451	7	1	120	110
Prodhime druri dhe letre	679	212	10	1	232
Tekstile dhe këpucë	13,789	776	748	1	477
Materiale ndërtimi dhe metale	2,421	1,082	50	690	2,713
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1,179	39	4	0	1,033
Të tjera	452	64	27	2	359